

BIBLIOTEKA

E

PAULIN SELIMI

8JH-1

53P

LILLEHØS

GJIROKASTER

**NUK
SHIHET
FYTYRA
VETEM
TE
PASQYRA...**

PIGRAME

814-1
339-

PAULIN S. SELIMI

NUK SHIHET
FYTYRA
VETËM
TE PASQYRA...

epigrame

33/63

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»


HERONJVE TË PUNËS SOCIALISTE

*Kalendari me inat
ju vështron se s'ka takat:
në uzina dhe në ara
ju vraponi më përpara!*



NAZISTËVE

*Kryqin e thyer e valëvitët në flamurë,
u thye kryqi i thyer, —
Shqipëria kurre!*




FASHISTËT

*Ti thirre: «Oh, ke bella Albania!»
kur zbrate për herë të parë në tokë, —
thirre pastaj: Oh, mama mia,
mos gjuani në kokë!»*



NJË INTRIGANTI

*Ti, shyqyr, je tip i rrallë,
kurrë nuk na del përballë...
...S'do ta marrë vesh mileti,
të mos prishet uniteti!*



FOLJA «S'DI»...

*Ti në punë e shoqëri
zgjedhon vetëm foljen «s'di»!
Dhe nuk lodhesh asnje fije,
me një «s'di» më shkurt i bie...*

«PARIMORI»

E di se ke parime,
nuk bën kurrë lëshime:
po tē lavdërova
më duartrokët,
po tē kritikova
ashpër më godet...



NJË PARAZITI

*Prindët në prehër, të mbajnë,
o asllan,
si shpërblim edhe ti
rrogën... ua mban!*



FLET E FLET...


*Flet e flet ti për kursimin
nga e hëna gjer të shtunë, —
por më kot e merr zotimin.
se kursen, por vetëm... punën!*



NJË HIPOKRITI

Dy vargje për ty s'po më dhimbsen sot
të të shqepin fort:


«Nuk ke karakter, e di tërë zyra!»
Vargu i dytë: «Por ke shumë fytyra!»



TRANSLATION

D Y P A M J E

*Sa shpesh autokritika
në fyt ty se ç'të ngeli, —
kurse për t'u shfajësuar
ke shenjë si Vilhelm Teli...*



I PAFJALI

Rri në mbledhje gojëkyçur
si fëmijët shembullorë, —
bubullin, porsa del jashtë,
si orteku me dëborë....




NJË KËPUCARI

*Më vret mua këpuca,
por s'qenka kjo e keqja:
kur unë çaloj rrugës
ty s'të vret aspak ndërgjegja...*



NJË TEKNIKU

Televizori im i prishur
figurën më në fund e nxori,
por edhe ti ma nxore shpirtin
nja gjashtë muaj, e di unë i gjori...
...Unë dhe qesja ime
se përsëri u dashkan riparime...



NJË AUTORI

*Nuk njihetjeta
vetëm me dieta...*




I ABONUARI

*Ishte i abonuar në çdo gjësim për raki,
i abonuar në çdo tryezë për të pirë kafetë...
I abonuar s'ishte, për çudi,
në asnje gazetë...*




NJË POETI

*U dërsite duke ndjekur kot figurën,
por kur nuk rrjedh uji, askush s'ta do urën...*



NJË REDAKTORI

*Një sy mbyll ti kur qëllon,
bëji katër kur redakton...*



NJË AKTORI

*Kurrikush me zor
s'të bën aktor,
por,
vërtet aktor
bëhesh me mund dhe zor...*

NJË SHKRIMTARI

*Mos u qaj, ke frymëzim,
skeçin e bëre tregim,
dhe tregimin — poezi,
nxirr tani një komedi, —
se po zgjatet muhabeti
bëj dhe një libret baleti...*

NJË SKEMATIKU

*Ti nuk lodhesh fare
se trajton çdo temë
ku dhë personazhet
flasin si në skemë:
dy grinden, dy qeshin
dhe në mes një vuani...*

*Skema e nxin letrën,
por ç'e do, nuk shkruan...*


NJË KOMPOZITORI

*Kur petët ende s'i kishin
dalë lakrorit
kujtoja se ti je i Institutit,
të Folklorit....*




NJË PIKTORI

Kudo veç makineri,
skela, diga, beton dhe hekur...
Në sfond duket një njeri,
që do dy orë për t'u gjetur...



PO PLAKET PA U BËRË NUSE...

Prej një dekade veprën nuk e lëshon nga dora
po thinjet, e shkreta, u zbardh porsi dëbora, —
po mplaket, e mjera, pa u bërë nuse...
ç'po heqin dhe lejet krijuese!



K U S H E D I...

*Kur më piktureve rashë në sëkëlldi,
me një trup gjigant, me muskuj si Tarzan, —
edhe flokët e bardhë m'i nxore ti të zinj,
s'e njoha veten, por nuk jam pishman:
më mbeti sot një ngushëllim,
mos, kushedi, del mundës biri im...*

NJE ROMANCIERI

*Thonë se shumë ujë ke futur në roman
dhe kripa të mungon*

të bëhej det tamam...



NJË AUTORI PËR FËMIJE

*Personazhi dymbëdhjetë vjeç
është fëmijë, por flet si burrë, —
i ndreq të tjerët, u bën moral,
sikur e paske lindur me... maturë!*


NJË KËNGËTARI PA DIKSION

*Në shtëpi nuk ke oreks,
je mësuar të hash... tekst!*



NJË ESTRADË

*Po s'patët humorin
që në popull kemi
sallën pa... popull
do ta gjeni!*



K R A H A S I M E

Të krijosh pa individualitet
është si të dalësh për gjah
me një çifte që nuk vret....



NJË «STUDJUESI»

Më në fund dhe ti e nise studimin
dhe shkencës iu fute me guxim si të tërë,
por me ndryshimin:
u more me një punë që të tjerët e kishin bërë.

NJË MJEKU

*Kot nuk flasin që të tërë,
je mjeku më "zemërgjerë"....
Po u ftoh ndokush n'pallat
merr raport komplet një kat...*



NJË BERBERI

Bakshishi është turp, këtë gjë e di mirë
dhe shpesh e përsërit ti që pagdhirë...
Bakshishi ty nuk të pëlqen,
ndaj s'e pranon, por as kusur nuk kthen...




NJË SPORTELISTI

Shprehja e mirënjohur «Nuk kemi vende»
për ty është si refreni


më i dashur

i një këngë...




NJË BASHKESHORTI

Pretekst për t'u bashkuar
është dashuria, —
pretekste për t'u ndarë
ti mund të gjesh me mijë...



NJË ORËNDREQËSI

Besa, nuk ka si ti,
ma rregullove orën për mrekulli,
vetëm tri herë në ditë më ngel,
tani në punë shkoj me... gjel!



OPERATIVITET

*Kaq shumë bredh pas mikut
sa dërsin në dimër si në mes të korrikut...*




N J È T I P I

*Njëshin shpejt e kthen në një mijë,
mizën buall ta bën ndër sy,
bile i tha një shoku: «Sivjet Viti i Ri
më kanë thënë se po vjen më dy...»*



NJË LLAFAZANI

*Sikur fjala ujë të ishte
liqen emrin do ta kishte...*



N J È L A P È S I

*Jam unë lapësi që po flas,
s'pyes për shi, erë, dëborë;
kohën kot s'dua ta vrás,
pse më mbani, miq, në dorë?
Një dhe një e dim' bëjn' dy,
por me lapës, jo me sy...*

NJË SHITËSI

Kaq shumë me mallrat dhe orarin lot
sa as kur ishe fëmijë s'ke lojtur me top...



NJË BANAKIERI

Mund të pihet çaji edhe pa sheqer
kur je i stohur dhe kolla të merr, —
por kafenë me kafe «shumë pak»
përse pa recetë e jep në banak?




NJË «KURSIMTARI»

*Në zyrë dy furnela elektrike,
lart pesë llampa për ndriçimin,
ndërsa ai me kokën në mes grushtash
vret mendjen për... kursimin!*




NJË ARROGANTI

*Kur shkove te një otorino
pasi të vizitoi u përmallua
edhe të tha: — Medet, qënke shurdhuar
nga të bërtiturat e tua!*




NJË E GOISTI

*Gati sa s'u mbyte
Një ditë në lumë, —
nuk thërrisje: — Ndihmë!
por thoshje vec: — Unë!*



KOMUNALES

Rrugët tona, moj komunale,
i ke bërë të hedhin valle:
hap e mbyll, e hap kanale...



NJË KRITIZERI

*Nuk le gjë pa kritikuar
prej mëngjesit deri në mesnatë, —
por një gjë e ke harruar:
se nuk pritet veç me shpatë...*

*Si fëmija që ndjek fluturën
kërko edhe ti të bukurën!*

NJË ZILI QARI

E more bredhin, e solle në shtëpi,
por menjëherë e preve me sëpatë,
se fëmija të tha: — Babi, shiko,
ky ta kaloka, qenka më i gjatë...



NJË GJYQTARI SPORTI

*Kurse faullet e paqena,
kurse tifon e sëmurë, —
kurse lojën «për të qenë brenda»,
ndershmërin' mos kursé kurre!*

NJË GRINDAVECI


Grindavec, o grindavec,


edhe vargu me ty ngec...



NJE SHITËSES

Thonë se vetrinën
e zbukuron për merak, —
edhe më bukur mallrat
që shet ti nën banak...






CİLESİ

*Sa ma ngjit ti gomën,
më shpohet biçikleta.*

*— Mos i hip, — më thua, —
që t'i zgjatetjeta...*


NJË KARRIERISTI

Të zuri një hall i madh:
t'i mbylli karriera sytë
sa shpesh ngjitesh n'kat të
pestë
dhe pse banon në kat të
dytë...




NJË MENDJEMADHI

*Ecën gjithmonë me kokë përpjetë
si çdo gjë që është e lehtë...*



S H K U R T

*C'do tē thotē tē jesh privat?
Me vezē pule tē nxjerrësh patē...*



N J Ė S Q A R I M

*Më pyete ç'do të thotë
të kesh në kokë lakër!
Po ja, bëhesh i tillë
dhe kur punon me hatër...*

1 2 3 N J E V A J Z E

*Nuk shihet fytyra
vetëm te pasqyra!*

N JË TRADHTARI


*Një natë pasi bëri pazarllëk
(siç bënte shpesh me rublën dhe dollarin)
seç u rishtri në një hendek
se shiti edhe varrin...*

MOS HARRO...

*Shteteve vasale që mbyten
në borxhe.*

*Njëra dorë lan tjetrën,
të dyja faqet lajnë, —*

*ti mbaje mend fort mirë, —
por huaja e re s'ta lan të vjetrën,
mbetesh pra me dorë të shtrirë...*



XHAMADANI

*Më mirë xhamadan nga lufta i djegur
sesa një smoking me diplomaci të rrjepur...*



EPITAFI I NGATËRRESTARIT

*Shko përpara, kalimtar,
mos u ndal ti tek ky varr, —
tërë jetën ky është përpjekur
saqë dhe i vdekur,
i del punë me të gjallë,
t'i sjellë prapë vërdallë...*

EPITAFI I PARAZITIT

*Këtu prehet ai
që vdiq pa lindur mirë,
se tërë jetën i tha punës:
— Lamtumirë!*

EPITAFI I SERVILIT

*Në varr s'ka qetësi,
po vuani ky i shkretë,
se nuk i mori lejë shefit
kur ndërroi jetë...*

EPITAFI I BUROKRATIT

Për herë të parë në tokë u ul ky burokrat,
kur u bë hyrje s'e pyetën aspak..,

EPITAFI I TE PAAFTIT

*Këtu prehet përjetë ai
që më në fund zuri një vend
me vlerën e tij...*

P E R M B A J N T J A

	Faqe
Heronjve të punës socialiste	3
Nazistëve	4
Fashistit	5
Një intriganti	6
Folja «s'di»...	7
«Parimori»	8
Një paraziti	9
Flet e flet...	10
Një hipokriti	11
Dy pamje	12
I pafjali	13
Një këpuctari	14
Një tekniku	15
Një autori	16
I abonuari	17
Një poeti	18
Një redaktori	19
Një aktori	20
Një shkrimtari	21
Një skematiku	22
Një kompozitor i	23
Një piktori	24

Po plaket pa u bërë nuse	25
Kushedi ...	26
Një romancieri	27
Një autori pér fëmijë	28
Një këngëtari pa diksion	29
Një estrade	30
Krahasime	31
Një «studiuiesi»	32
Një mjëku	33
Një berberi	34
Një sportelisti	35
Një bashkëshorti	36
Një orëndreqësi	37
Operativitet ...	38
Një tipi	39
Një llafazani	40
Një lapësi	41
Një shitësi	42
Një banakieri	43
Një «kursimtari»	44
Një arroganti	45
Një egoisti	46
Komunales	47
Një kritizeri	48
Një ziliqari	49
Një gjyqtari sporti	50
Një grindaveci	51
Një shitëses	52
Cilësi	53
Një karrieristi	54
Një mendjemadhi	55
Shkurt	57

Faqe

Një sqarim	58
Një vajze	59
Një tradhtari	60
Mos harro	61
Xhamadani	62
Epitafi i ngatërrestarit	63
Epitafi i parazitit	64
Epitafi i servilit	65
Epitafi i burokratit	66
Epitafi i të paaftit	67

Selimi, P.S.

Nuk shihet fytyra vetëm te pasqyra.... Epigrame. [Red.: D. Bubani] T.,
«Naim Frashëri», 1985.

72 f. me il.

(B.m.): 891.983-193.2

(B.v.): 891.983-1

S 39

Tirazhi 1500 kopje Formati 70x100/32 Stazh: 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1985

